



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM
PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË
KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE,
PJESTARE E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për pranimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive: Durrës, Fier, Lezhë, Tiranë, Kamëz, Vlorë të paraqitura nga Partia Aleanca Demokristiane, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1 dhe pika 2, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia Aleanca Demokristiane, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia Aleanca Demokristiane, me vendimin e KQZ-së nr. 31, datë 04.03.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e



Nr. 626 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Aleanca Demokristiane", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

KQZ-së nr.251, datë 7.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia Aleanca Demokristiane.

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtar në Këshillin e Bashkive: Durrës, Fier, Lezhë, Tiranë, Kamëz, Vlorë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkive: Durrës, Fier, Lezhë, Tiranë, Kamëz, Vlorë; pasi këto bashki administrohen nga më shumë se një KZAZ.

KQZ me vendimet nr. 429, datë 16.05.2019, nr. 432, datë 16.05.2019, nr. 436, datë 16.05.2019, nr. 528, datë 18.05.2019, nr. 531 datë 18.05.2019, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkisë Lezhë, Kamëz, Durrës Tiranë, Vlorë. Brenda afatit Partia ADK nuk ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimit të KQZ-së për Bashkin Vlorë, dhe Lezhë. Në këto kushte KQZ referuar nenit 73, pika 2 duhet të refuzojë listat e kandidatëve për Këshillin e bashkisë Vlorë, Durrës dhe Lezhë të Partisë Aleanca Demokristiane.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive Fier, Kamëz, Durrës dhe Tiranë;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtar këshilli në Këshillin e Bashkive: Fier, Kamëz, Durrës dhe Tiranë, të propozuar nga Partia Aleanca Demokristiane;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës 18.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Bashkive: 1.Fier, Kamëz, Durrës dhe Tiranë, të Partisë Aleanca Demokristiane dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që të përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuara nga ligji 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe



Nr. 626 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Aleanca Demokristiane", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për kryetar bashkie, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore sipas së cilës rezultojnë të se:

BASHKIA Lezhë, Kandidati Ndue Nikoll Simonaj (me numer rendor 07) . Me vendim nr.154 dt. 04.04.2014 Gjykata e rrethit Gjyqësor Lezhë e ka deklaruar fajtor për veprën penale të drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 K.P. dhe neni 406 K.Pr.P. dënohet me 2(dy) muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 K.P. zëvendësohet dënimi me burgim me punë në interes publik prej 100 orësh. Në bazë të nenit 69 K.Penal është rehabilituar.

Bashkia Kamëz, Kandidati Leo Ali Muneka (me numër rendor 05). Në bazë të vendimit nr.2943 datë 29.09.2016 Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë e ka deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale "Moskallëzim krimi" dhe bazuar në nenin 300 të K.p. dhe 406/1 të K.Pr.P dënohet me 100.000 lekë gjobë. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.Penal.

Bashkia Kamëz, Kandidati Elton Bajram Nuzi (me numër rendor 21). Me vendim nr. 760, dt. 11.03.2016 Gjykata rrethit Gjyqësor Tiranë e deklaroi fajtor për veprën penale përveçësimit i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtari kriminale, e në bazë të nenit 287/b K.P. dhe nenit 406K.Pr.P e dënon me 2 muaj burgim. Në bazë të nenit 59 K.P. Pezullohet ekzekutimi vendimit për 2 vjet. Gjykata e Apelit me vendim nr.498, dt.05.04.2017 vendosi lënien në fuqi të vendimit. Rehabilituar në bazë të nenit 69 të K.Penal

Bashkia Kamëz, Kandidati Vladimir Rexhep Milloshi (me numër rendor 19). Me vendim nr.(634) 74, datë 25.05.2018 Gjykata e rrethit Gjyqësor Kukës e deklaroi fajtor për veprën penale "Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror" Parashikuar nga neni 297 të K.penal e dënuar me 50.000 lekë gjobë. Zyra e gjendjes gjyqësore nuk ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, Bashkia Fier, .

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 22.05.2015, verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, Kamëz, Durrës dhe Tiranë dhe dokumentacionin bashkëngjitur, të depozituar nga "Partia Partia Aleanca Demokristiane" dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 dhe pika 2 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Fier, Tiranë, Kamëz dhe Durrës të Partisë Aleanca Demokristiane, pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Refuzimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë të Këshillin e Bashkive: Vlorë, dhe Lezhë të Partisë Aleanca Demokristiane, pjesëtare të Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.



Nr. 626 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga "Partia Aleanca Demokristiane", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019